



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 5, datë 30.04.2024.

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria” (Ora 10²³)

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Vullnet Bilbilaj | 22.Vjola Xhafaj |
| 2.Brikena Sika | 23.Englantina Imeraj |
| 3.Simo Petromilo | 24.Lorel Canaj |
| 4.Illir Aliaj | 25.Ledja Shollaj |
| 5.Novrus Rrokaj | 26.Arjan Isufi |
| 6.Endri Hyseni | 27.Liljana Breshani |
| 7.Shkëlqim Leskaj | 28.Alta Haluci |
| 8.Myzafer Elezi | 29.Atird Hoxha |
| 9.Ervis Moçka | 30.Geron Gunbardhi |
| 10.Jerina Dervishaj | 31.Elca Bezhani |
| 11.Rajmonda Zoto | 32.Edison Kapaj |
| 12.Besmir Brahimi | 33.Elpiniqi Mërkuri |
| 13.Sokol Kushta | 34.Briseida Çakërri |
| 14.Eglantina Aliaj | 35.Gëzim Çapoj |
| 15.Simbol Pazaj | 36.Refie Laze |
| 16.Gjergji Nika | 37.Aurora Qarri |
| 17.Liri Dëma | 38.Grigor Dede |
| 18.Edlira Kapllanaj | 39.Anxhela Shenaj |
| 19.Frosina Qyrdeti | 40.Eda Begaj |
| 20.Evis Allushi | 41.Arsen Belaj |
| 21.Roland Strakosha | 42.Anisa Ceno |

Mungojnë:

- 1.Brikena Puka
- 2.Ardian Musta
- 3.Marsela Dashi
- 4.Eneida Vera
- 5.Klodian Xhyheri
- 6.Erëmal Arapi
- 7.Dikens Bushaj
- 8.Mujo Shakaj
- 9.Bujar Osmënaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 5/1, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes!

Fillojmë mbledhjen me shprehjen e ligjshmërisë. (Lexon shkresën e ardhur nga institucioni i prefektit të qarkut) për vendimet e këshillit të bashkisë Nr 19 – 31, datë 28.03.2024, ku janë vlerësuar të ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë .

Kalojmë në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar , datë 28 .03.2024.

Kush është pro ?

Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Vijojmë me rendin e ditës. Ndonjë pyetje ?

Lidhur me rendin e ditës, ju ka ardhur në e-mail dhe një projektvendim shtesë , “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 29.12.2023 në buxhetin e bashkisë për vitin 2024”

Është diskutuar dhe në komisione.

E votojmë për të futur në rendin e ditës ? Votohet .

Pro – 36 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 5/2, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në projektvendimin “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin mars 2024”.

Diskutime ? - Jo.

Kalojmë në votim.

Pro – 36 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 5/3, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin mars 2024”.

Diskutime ? E kalojmë në votim ?

Pro – 36 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 5/4, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zonjës Shpresa Barjamaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”. Relaton kryetari i komisionit juridik.

Z.Endri Hyseni – Janë dy projektvendime me të njëjtin objekt, dhënie ndihmë financiare.

Znj.Elpinqi Mërkuri – I kalojmë në votim?

Votohet

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 5/5, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Renato Sullaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim?

Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 5/6, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë, për çdo rast”.Një relacion nga komisioni përkatës.

Z.Endri Hyseni – Edhe ky projektvendim u diskutua në mbledhjen e komisionit juridik. Janë 7 familje, kërkesa për tu trajtuar nga administrata. E vetmja gjë që u theksua , është mënyra e informimit publik të qytetarëve në rajone dhe njësitë administrative. Le të kalojmë në votim për miratim , për këto 7 subjekte.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 5/7, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 6 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara”.

Z.Endri Hyseni – Edhe ky projektvendim u diskutua. Janë 2 familje që kanë aplikuar për privatizim banese. Është dokumentacioni i rregullt, relacioni.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim .

Pro – 38 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 5/8, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “ Për përcaktimin e procedurës për negocimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Vlorës, nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj “.

Z.Endri Hyseni – Jemi njohur me këtë material nga administrata. Është një projektvendim që u vjen në ndihmë të gjithë privatëve për të zhvilluar pronën. I kemi lexuar të gjitha pikat. Ky projektvendim do t’ju vijë në ndihmë subjekteve private që, në marrëveshje me bashkinë të zhvillojnë pronën. Minimumi i fitimit është 25%.... e pastaj do të futet në marrëveshje.

Nëqoftëse, ka ndonjë diskutim, por ne në komision ramë dakort.

Znj.Alta Haluci – Mendoj ti dëgjojmë të gjitha dhe që këto dokumenta të shikohen, që për çdo projektvendim, të shihet nga ekspertë të fushës. Lexon ...

-Mosrespektimi i rregullave..konstatime të përgjithëshme dhe konkrete;

-Në projektvendim , nuk është dhënë referenca,

-Projektvendimi nuk është bërë në përputhje...

-Dispozitat nuk janë të lehta për tu përdorur...

-Nuk kanë përcaktuar datën kur do hapen procedurat ..

Problematikat :

-Paragrafet, baza ligjore ka gabime sintaksore (Lexon ...bashkëlidhur relacioni i zonjës Alta Haluci)

-Në paragrafët 8 dhe 9, përdorimi i termave ...

-Strukturimi i paragrafëve, nuk është bazuar në rregullore.

-Projektvendimi, nuk përcakton në mënyrë të qartë dhe shterues ...

-Paragrafi 7 ...përbërja e komisionit, kufiri ndarës midis komisionit dhe kryetarit të bashkisë.

Kryetari i bashkisë, është përgjegjës në mardhënie me të tretët.

-Në paragrafin 10 ..Ligji “Për strehimin “ dhe transferimin e pronave...

-Paragrafi 16...Në projektvednim nuk është përcaktuar qartë kufiri me privatën.

-Paragrafi 4...Këto janë pikat. I kam depozituar pranë sekretariatit.

Z.Atird Hoxha – Pa hequr asnjë presje , ky projektvednim është marrë copy past nga bashkia e

Tiranës. Ky është ligji “Fusha “ për teatrin kombëtar. Ky është një projektvendim, nuk ka asnjë kufizim ku , administrata të hyjë në marrëveshje me privatën. E para duhet të dimë, inventarin e pronave të Bashkisë Vlorë..Ka prapavijë të dyshimtë dhe, ky kryetar, kjo administratë të bëjë këtë të bashkisë Tiranë. Ky është copy past nga kompania “Fusha “.

Z.Endri Hyseni – Është një përcaktues për procedurën dhe më vonë , rast pas rasti. Pra, proceduriale . Thjesht përcaktohet procedura dhe pastaj çdo marrëveshje do vijë në këshill, rats pas rasti.

Z.Sokol Kushta – Shumë nga ne kanë zhvilluar pronën. Kryesorja që ka një kufi. Si është bërë më parë kjo procedurë, si është zhvilluar kjo pronë, kur nuk ka pas kufi bashkia ?

Më duket iniciativë shumë e mirë. Ne duhet të shikojmë zhvillimin e pronës, por për më saktësimë i ka administrata.

Z.Gjergji Nika – Në komisionin e financës, zoti Gunbardhi ka 9 muaj që kërkon listën e pronave, të aseteve të bashkisë. Ne nuk kemi një listë, çfarë do jepni ? Në Rajonin Nr 3 ka kontratë shkëmbimi për pallate .Keni 12 vjet që nuk merrni dot pronat dhe nuk dini çfarë pronash keni ? Këtë e rregullon lista, jo rregullorja. Juve, 9 muaj nuk mund të na jepni listën e pronave. Juve s’ dini çfarë keni . Zoti Kushta, kjo nuk e rregullon.Vetëm 2 prona keni.

Znj.Elca Bezhani – Administrata tha, që po e përgatit listën. Janë në procedurë.

Z.Gjergji Nika – Na sillni një listë me pronat, pastaj e rregullojmë.

Znj.Elca Bezhani – Nuk do përcaktohen raste pa na ardhur lista.

Z.Gjergji Nika - Keni bërë një kontratë shkëmbimi në Rajonin 3 për të ndërtuar. Çfarë keni marrë mbrapsht ?

Z.Ermal Dredha – Kjo është thjesht një procedurë, nuk na pengon dhe pse se kemi listën.

Jemi në marrëveshje me ASHK, ka dhe një kosto për këtë. Gjithçka do kalojë në komitet teknik dhe këshill,do shikohet rast pas rasti. Por çdo gjë do ndërtohet për komunitetin. S’kemi filluar negocimin me asnjë., vetëm gjenerojmë të ardhura. Vërtet ka kosto, por po bëjmë procedurat.

Edhe zonja Alta, në lidhje me terminologjinë juridike, do ti respektojmë, mund të reflektohet...Ne në parim ta kalojmë, transparenca do të jetë..., të kemi një marrdhënie të drejtpërdrejtë me njëri tjetrin, përfitojnë komuniteti dhe bashkia dhe kthehen në investime.

-Për marrëveshjen, e kemi evidentuar si rast , kemi marrë dhe marrëveshjen, jemi në bashkëpunim me zyrë noteriale, për të marrë çka i takon bashkisë.

Z.Geron Gunbardhi – Kur flasim që kemi 9 muaj..., ne për një kërkesë dhe s’ marrim përgjigje. E dimë që duhet bashkëpunim me ASHK-në dhe ka kosto...Ka projekte të bukura Problemi është , që ne, pse dalim kundër..., Ne jemi pro gjithmonë në interes të qytetarëve. , të mbledhen taksat për tu kthyer këto në investime. Thamë për mbledhjen e taksave nga Ujësjiellësi, për taksën e tokës me qira.

Zoti Kryetar! Sa kohë ju duhet për të bërë ato që ju kërkon ligji, për të mbledhur këto taksat për të fituar qytetarët...Po prishen shtëpi dhe do bëhet një projekt i bukur, të përfitojnë qytetarët. Ne nuk ju pengojmë. Borxhi i Ujësjiellësit, po ju shtohet. Shumë punonjës të Ujësjiellësit që shkojnë në gjykatë..., të gjitha janë humbje nga taksat e qytetarëve.

Z.Ermal Dredha – Kjo është një marrdhënie dhe vendimmarrje parimore. Duhet të kalojë thjesht për procedurë. Përsa i përket prishjes së objekteve, ka 4 vjet ky projekt .Ishte procedurë e ngelur, projektin do e vazhdojmë. Është një VKM, duket sikur bashkia nuk bashkëpunon. Jam takuar me këta qytetarë , qoftë për shpronësimet, qoftë me ASHK-në.

-Përsa i përket Ujësjetës...E ka fajin bashkia se fitohet gjyqi ? Dëmi në fund, është në kurriz të shtetit. Jam i informuar për këtë që po ndodh.

Z.Illir Aliaj – Edhe ky projektvendim, kaloi në komisionin e infrastrukturës. Në komision u bë një shtesë që, të caktohet nga administrata e bashkisë një person përgjegjës deri në rregjistrimin e saj në hipotekë. Nëqoftëse, do shtohet dhe kjo pikë , pra, të ishte një drejtori për vazhdimin dhe kontrollin e procedurën. Përsa i përket pjesës tjetër, për rregjistrimin e aseteve, nga administrata morrëm informacion që, po merren me këtë punë, por ky projektvendim nuk e pengon, por i hap rrugë bashkisë për negociimin me pronarët privatë. Mendoj ta kalojmë sot në këshill për miratim.

Z.Shkëlqim Leskaj – Është problem i hasur në vite, për zhvillimin e pronës, kur kemi në kufi pronën shtet. Kemi raste të ndryshme. Në këtë projektvendim, zgjidhet kjo gjë,për të zhvilluar pronën private, ku bashkia negocion me biznesin privat. Është thënë dhe përcaktuar dhe përqindja, kufiri minimal 25%. Në rastin kur zhvillohet prona, është dhe pronar trualli është dhënë dhe përqindja, që fiton bashkia. Pra, është një zgjidhje si për privatin, biznesin dhe bashkinë. Bashkia do marrë masa që kjo të kalojë pronë e bashkisë dhe hyn në negociata me pronarin e tokës, me bashkinë. Ftoj ta miratojmë.

Z.Arjan Isufi – Problemi i ndërtuesve, mes tyre dhe praonës së bashkisë, ligji e ka zgjidhur, sepse pronari i bën kërkesë Ministrisë së Ekonomisë për ta blerë. Pra, s’kemi asnjë ngut për miratimin e këtij projektvendimi, pasi duhet të ketë pjesë integrale me ..., pra listën e pronave të bashkisë.

Pra, ky projektvendim me këtë listë pronash bashkëlidhur, të vijë të miratohet.

-Në faqen 3 , pika “g” lexon... garanci 1% të investimit total ..shembull...Është qesharake në total për shembuj të shumtë. Ky penalitet me 1%, nuk është gjë. Mendoj, minimalisht 10% që, ata që do ndërtojnë të mendohen mirë..

-Në pikën 1 , lexonta marrë nga bashkia me shkrim.... Jo nga bashkia, por nga këshilli miratimin.

-Terminologjia lë për të dëshiruar.

Znj.Elca Bezhani – Ne jemi në komisionin e financës me zotin Nika dhe Zotin Gunbardhi . Mundohemi të kemi mendime konstruktive. Shpeshherë këshilltarët kanë bërë kërkesa të ndryshme dhe asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje në kohë , për probleme të ndryshme. Ka neglizhenca në lidhje me kthimin e përgjigjeve të këtyre kërkesave. Lidhur me kërkesën e fundit ..., janë dërguar dhe shkresa të tjera, midis të tjerave dhe për interperlancë për Kryetarin e bashkisë.

Admisnistrata duhet të reflektojë , të punojë. Performanca ka çaluar në Bashkinë Vlorë, pra s’mund të dimë si kanë punuar dhe ku po shkojnë. Të merret në konsideratë nga administrata.

Znj.Edlira Kapllanaj – I dëgjova këshilltarët. Ky projektligj, është një nismë në të mirë të qytetarëve.

Në lidhje me problemin e strehimit, ndryshon midis banesave sociale dhe atyre me kosto të ulët. Është i domosdoshëm ky projektligj dhe administrata ta shohë dhe përdorë për politika të strehimit.

-Nga komisioni të përgatitet një sistem pikëzimi , për bizneset.Jam pro këtij projektligji, pra ti shtohen dhe problematikat e thëna.

Z.Gjergji Nika - Në lidhje me përgjigjet e kërkesave , të lihet që gjatë muajit maj të bëhen 2-3 mbledhje të komisionit, ku drejtorët të raportojnë në Komisionin e Financës .

Z.Endri Hyseni – Lidhur me pretendimin e zotit Arjan, ekziston mundësia e blerjes, por në atë rast, interesi është ai privat. Ndërsa me këtë, interesi është i qytetarit dhe bashkisë.

Z.Myzafer Elezi - Jemi dakort në parim me këtë projektvendim. Në mënyrën si paraqitet projekti sot, ti shtohet fjala e zonjës Alta dhe propozimi i zotit Arjan , ky projektvendim të tërhiqet, në formën që , nuk e ka konsensusin.. Në mbledhjen që do vijë të jetë i rregulluar dhe të votohet.

Z.Gëzim Çapoj – Kjo është shumë e rëndësishme. Nuk i lejohet administratës së bashkisë që nuk ka listën e pronave.

Z.Dorian Demiri – Nuk diskutohet kështu.

Z.Gëzim Çapoj – Mendoj që në mbledhjen e ardhshme të vijë kjo listë me pronat shtet që bashkia i merr.

-Pronar i vetëm i bashkisë, është këshilli i bashkisë. Pra, për çdo pronë që të kalojë për zhvillim, të kalojë në këshill. Jam dakort të kalojë ky projektvendim.

Z.Dorian Demiri – Më vjen keq, nga këshilltari Nika. Ne e kemi diskutuar dhe kemi thënë që ka nisur procedura. Do kohën e saj.

Z.Gëzim Çapoj – Sot sillni një projektvendim , duhet të ketë një listë pronash.

Z.Dorian Demiri – Jemi dakort me zotin Isufi për 1%....Diskutojmë termin, nuk e pranoj..ka një inventar paraprak.

Z.Gjergji Nika – Do ngremë një komision hetimor për të gjithë drejtoritë.

Z.Dorian Demiri – Diskutojmë në lidhje me projektvendimin. Është e përcaktuar ..., në lidhje me diskutimin e zonjës Haluci ...

Z.Atird Hoxha – Është e papranueshme që, administrata të futet në debat me këshilltarët. Nuk mund të futet në komente administrata me këshillin. Administrata është e detyruar të kthejë përgjigje ose paqartësitë që kanë këshilltarët. Ju zonja kryetare duhet të ndërhyri, mos të bëhet kakofoni. Dhe ajo presje, ndryshon kontratën.

Zoti Demirindërtesa individuale... ndërtesë 1 pallat , banesa për qëllime...Pra, ato shenja, pikë dhe presje , kanë shumë rëndësi..Ju nuk keni sjellë inventarin. Nuk mund të votojmë parimisht, kryetari nuk mund të hyjë në negociata. Kërkoj që, ky projektvendim ose të hiqet sot, ose ne do votojmë kundër.

Z.Ervis Moçka – Për projektvendimin, nisur nga diskutimet ...Në fakt e kam kërkuar dhe e

përsëris , për zbatimin e rregullores, neni 91..Rregullorja dhe nga kritikata , dhe nga pikëpyetjet e zonjës Haluci...Kush është qëllimi dhe objektivi ?

Doja të dëgjoja reflektimin e drejtorisë përkatëse, propozimin e aktit..Ka pas disa konsultime publike , ka pas dhe biznese , ka pas dhe propozime. Edhe nga diskutimi për 1% , mund ta risim ose ta ndryshojmë. Jam dakort që ka mangësi, por kryesorja , është që mungon lista e aseteve. Pra, ta shtyjmë projektvendimin se mungon lista e aseteve, apo të pengojmë privatin për të zhvilluar pronën.

Nëqoftëse e kalojmë sot, është një lehtësim. Po të vonohet , kjo do vërë në vështirësi privatin apo bizneset për zhvillim. Pra, i vetmi argument, është lista e aseteve. E vetmja gjë, është ta kalojmë sot, t'ju japim mundësi ndërtuesve.

Z.Gjergji Nika – Mos tu jepet mundësia oligarkëve për të zhvilluar pronën.

Përsa i përket përqindjes, 25% nuk cënon. Propozime konkrete keni nga zonja Haluci dhe zoti Isufaj. Implementoni , dhe legjislacionin ..

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votë.

Pro – 29 vota

Kundër 13 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 5/9, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 8 e rendit të ditës, projektvendimi “ Për miratimin e Rregullores për shfrytëzimin e hapsirave publike “.

Një relacion, drejtori i urbanistikës.

Z.Dorian Demiri – Projektvendimi është një rregullore për menaxhimin e hapsirave publike. Kemi aktivitetin e lejuar dhe në vazhdimësi kemi të gjitha elementët , modelet e tendave që i kemi ndarë ...ëpr këtë do flasë drejtori i urbanistikës.

Z.Klaudio Mehmetaj – Ky projektvendim është i domosdoshëm për menaxhimin e hapsirave publike. Ka 7 krerë.(lexon)

Objekti: Hapsirë publike, është hapsira e jashtme si, sheshi, trotuarë, lulishte.

Hapsira publike janë mjedise të hapura..hapsirë publike është pronë e përbashkët...Është i ndaluar shfrytëzimi i hapsirave publike, pa lejen e bashkisë.

Qëllimi :Përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve për përdorim sa më të mirë të hapsirave publike....

Në pjesën e dytë, është detajuar procedura për shfrytëzimin e hapsirës publike..Është një rregull pas dëgjësës publike në komisione.

Në kreun 3, paraqiten kriteret e vendosjes , distancat e paraqitura dhe pajisjet e lejuara ...

Kreu 4 , rregullon ekspozimin e mallrave dhe vendosjen e pajisjeve.

Kreu 5 , kriteret për zhvillimin e panajreve ..

Kreu 6, përcakton rregullat për dhënien e lejes për zhvillimin e aktivitetit...

Kreu 7, përcakton rregullat për reklamimin e bizneseve, dimensionet dhe distancat ...

Nisur nga sa u tha më lartë , kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi, si domosdoshmëri për shfrytëzimin sa më mirë të hapsirave publike.

Z.Atird Hoxha - Kërkoj të saktësoj që, ne si grup nuk jemi kundër interesave publike. Do ta mbështesim kryetarin e bashkisë, administratën , por në momentin që kanë interesa okulte..., jemi për të mbrojtur interesat publike,...pa përdorur fjalët.. oligarkë etj...

Kam vërrejtje për këtë projektvendim.

-Pika 2 e këtij projektvendimi..lexon.. çdo leje ...cënohet siguria juridike ...Ne sot, pra administrata me rregulloren, me një pikë të saj mund tëlexon..Pra, kjo pikë, duhet të përfundojë atje ku është presja, pra ku mund të bëhet dhe më një pikë tjetër ...cënon sigurinë juridike.

E dyta, në rregullore në paragrafin 3 ...objekti i kësaj rregullore lexon... bie-ndesh , nëqoftëse do kthehen në lulishte për tu zhvilluar me të tretë..

Pra, mundet kurrsesi që këto terma, pasi kryetari i bashkisë, nuk mund ti kthejë në pika për zhvillimin e aktiviteteve këto parqe.

Pika 4 ..lexon..pavarësisht rregjimit juridik...rregjimi juridik, mund të jetë pronë private.

Pra, është terminologji e gabuar, pavarësisht rregjimit juridik....në pronësi të Bashkisë Vlorë.

Mendoj që, dhe kjo në vazhden e projektvendimit të mëparshëm...

Në lidhje me dëgjesta publike, të bëhen njoftimet në kohë..Kërkoj miqësisht që ky projektvendim të rishikohet.

Z.Ervis Moçka – Është ndërgjegjësimit i qytetarëve për dëgjesat publike. Përsa i përket propozimeve të këshilltarit, të thuhet dhe në komisionin juridik, por ju jap të drejtë për nenin 2, pika 2 është e vërtetë cënohet siguria juridike. Pra, jam dakort , duhen ndryshuar dhe, atje ku ishte presje, të vihet pikë.

-Shqetësim tjetër, ku ftoj administratën të shikohet struktura e përkohshme mikse...ti sillte në një moment të dytë bashkëlidhur me një format dhe një hartëzim..

Struktura të përkohshme mikse(kioskë) , le të hiqet. Të silltet një hartëzim siaps zonave.

Është propozim që administrata ta marrë në konsideratë..Është mirë të kemi një rregullore për zënien e hapsirave publike.

Z.Gjergji Nika – Rregullorja është shumë e mirë, por duhej bërë më parë. Janë dhënë 800 leje.

Pra, nga diskutimet me propozimet e bëra , propozoj të tërhiqet ky projektvendim, të sistemohen të gjitha pikat. Vërtet që ka kaluar në komisionin juridik, por jemi 51 këshilltarë që duhet të gjykojmë.

Jam dakort ta tërheqin projektvendimin, të bëhen korigjimet e duhura , dhe të silltet për miratim , ta votojmë.

Z.Arjan Isufi – Në faqen e parafundit , paragrafi 2, lartë pjesa e dytë..lexon..

Çlidhje ka DAV me rikreative dhe restorativePra drejtorisë së Turizmit, Drejtorisë së Aseteve..Pse ti'a japim DAV. Pra të rishikohen, të rregullohen..Drejtoritë e Turizmit, e Aseteve dhe Urbanistikës, të zëvendësohen këto.

Z.Myzafer Elezi – A kemi një mospërputhje me terminologjinë ? Emërtimi i projektvendimit ndryshon me atë të rregullores (lexon). Propozoj që emërtimi i draft projektit të jetë i njëjtë me të rregullores.

Z.Dorian Demiri – Është bërë ndryshimi.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Në çdo komision ky projektvendim ka pas debate dhe propozime. Ditën e hënë u la , të vinte rregullorja e përmirësuar nga administrata.

Z.Gjergji Nika – Po të ishte rregulluar, të na vinte.

Z.Atird Hoxha – Për procedurë. Përsa i përket fjalëve që këshilltarët thonë,ky ose do votohet me ndryshimet e propozuara, ose do hiqet ose sipas propozimit të zotit Moçka ?..

Pra, në votim, kështu thuhet. Hidhet në votim me ndryshimet e propozuara. Nëqoftëse, është për tu rregulluar le të tërhiqet. Të njihen këshilltarët me rregulloren. Nëqoftëse, s'ka asnjë penalitet, le të tërhiqet dhe të vijë.

Z.Dorian Demiri – Gjithë propozimet, i kemi pasqyruar në rregullore, në lidhje me ngritjen e strukturave, DAV ndryshon me drejtori përgjegjëse Drejtorinë e Aseteve. I kemi reflektuar. Jemi dakort dhe për struktura të përkohshme mikse.

Z.Gjergji Nika – Patjetër që është e mirë rregullorja. Tërhiqeni dhe silleni në rregull.

Z.Ervis Moçka – E diskutuat shumë mirë zoti Hoxha ...Procedura është e saktë. Nga komisioni juridik , u bënë propozime, këta ta relatojnë, pra, do votohet rregullorja me çdo ndryshim të propozuar..Propzimi i zotit Isufi, që mos të merret vetëm me një drejtori DAV, u reflektuan...Bëhen propozimet dhe hidhen në votim. Pse të vonohet rregullorja? .për disa propozime ?

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ta hedhim në votim me gjithë propozimet e bëra nga këshilltarët si dhe në mbledhjet e komisioneve ?

Z.Gjergji Nika – Për këto dy projektvendime, do tu ngelen bizneset tek kryetari i bashkisë. Do shihni këto reagime nga qytetarët.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim me propozimet e bëra ?

Z.Ervis Moçka – Po japim dakortësinë, me propozimet e bëra . Ta kalojmë në votim me propozimet përkatëse.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Propozoj ta kalojmë në votim me ndryshimet e propozuara të këshilltarëve dhe nga komisionet përkatëse. Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër - 10 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 5/10, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Viojmë me pikën 9 të rendit të ditës, projektvendimi Nr 9 “Për miratimin e rishikimit të Programit të Transparencës së Bashkisë Vlorë “.

Ka një referim nga kryetari i komisionit?

Z.Endri Hyseni – Jemi njohur të gjithë me këtë projektvendim. Është mbështetur në ligjin “Për Vetqeverisjen Vendore “. Është parashikuar të bëhet rishikimi i transparencës , plus tabelën bashkëlidhur.U pasqyruan të gjitha propozimet e bëra.Ky program pas miratimit në këshill, do jetë i publikuar dhe në Eëb-in e bashkisë. Është mbështetur në ligj. Mendoj ta kalojmë për miratim. Është çështje procedure.

Z.Gjergji Nika – Në parim, jam pro, por për propozimet e bëra në komision, janë ndryshuar, a janë pasqyruar? ..në pikat ...për kryetarin e bashkisë , të shtohet edhe këshilli bashkiak, pikat 8 dhe 9.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim me ndryshimet e propozuara. Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 5/11, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 10 e rendit të ditës, projektvendimi i radhës “ Për një saktësim në Vendimin Nr 6, datë 29.01.2024, të Këshillit të Bashkisë “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave , në lagjen “Kushtrimi “, tek ish-Frigoriferi Vlorë”.

Është projektvendim me firmën time, i cili ka të bëjë me saktësimin e pikëzimit të zonjës Arjola Sinani . Ka kaluar herën e kaluar, ne e miratuar për tek shtesat..Më pas nga administrata , nuk është shpallur tek pjesa që kemi propozuar për ta kaluar dhe zonja ka bërë ankesat e saj. Në komisione ka patur reagime negative nga këshilltarët.Unë kam bërë dhe një projektvendim tjetër, i cili i jep fuqi administratës që të sjellë një projektvendim tjetër, ku të rivlerësojë dosjen e zonjës Arjola, ku së bashku me këtë zonjë është dhe zonja Arjana Mamushi, e cila është kategorizuar në 1+1 nga administrata. Në të vërtetë ka pasur mangësi në dokumentacion, pasi nuk ishte e martuar dhe ndërkohë e ka shtuar celebrimin dhe kërkon të kalojë në kategorinë 2+1, me 4 persona. Pra, jemi me dy emra. Kam 2 projektvendime, pra, që ne sot të marrim vendim për këto të dyja dhe projektvendimi që, ti japim fuqinë administratës të shprehet. Cilin doni të votojmë , ta marrim fuqinë neve ?

Z.Gjergji Nika – Projektvendimin e dytë , nuk e kuptoj.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ti jepet fuqia administratës , të bëjë një projektvendim. Unë dua të jem korrekt me propozimin.

Z.Gjergji Nika – Kryetarët e grupeve ti hedhin një sy..Projektvendimi i parë është në rendin e ditës dhe është për votim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – I dyti, është ti japim fuqinë administratës, pra, projektvendimi i parë zonja Arjola bashkë me zonjën Arjana dhe i dyti , të kthehet mbrapsht të vijë nga administrata.

Z.Illir Aliaj – Projektvendimi i parë, për zonjën Arjola Sinani , ne si këshill e miratuar në listë pritje...Ose nga administrata e bashkisë u bë një lapsus, ose ne duhet të mbanim

të njëjtin standart me të tjerët, me pikëzim. Unë mendoj të kalojë ky projektvendim dhe zonjës ti vihet pikëzimi.

Për zonjën Arjana Mamushi , në dokumentacionin e saj , e kishte bërë me bashkëjetues dhe përfitonte 1+1. Ajo tashmë ka bërë celebrimin dhe kërkon ta ndryshojë . E para, Arjola të bëhet me pikëzim, të kalojë në votim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim Znj.Arjola Sinani ?

Pro – 40 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Pika tjetër, për znj.Arjana Mamushi .

Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Faleminderit të gjithëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 5/12, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Projektvendimi shtesë, “ Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB N 100, datë 29.12.2023 për buxhetin e bashkisë për vitin 2024 “.

Znj.Elca Bezhani –Administrata në këtë projektvendim, i kërkon këshillit, të rishikohet fondi në dy tituj të investimeve. Administrata kërkon të rishikohet fondi për hapsirën publike , për ndërtimin e një rruge tek “7 Pallatet “, dhe mirëmbajtjen e varrezave ..., tjetër gjë ... 602, për shpenzime operative, për mirëmbajtjen e varrezave publike

Në komisionin e financës u diskutua. Ligji e parashikon rishikimin e fondeve. Rishpërndarja e fondeve bëhet nga këshilli. Meqenëse këto arsye dhe analiza, na janë dhënë., propozoj të kalojë për miratim.

Z.Endri Hyseni – Ky projektvendim është i bazuar në ligj. Në komisionin juridik, u propozua tek pika 1,të ndryshojë , jo miratimi ...por, të miratohet ndryshimi i zërit buxhetor...vlera e investimit.Të ndryshojë kodi, i vetmi propozim.

Z.Atird Hoxha – Kam një pyetje. Rruga tek “7 pallatet “ ka qenë e parashikuar në buxhet ?

Z.Klaudio Mehmetaj – Ky ka qenë një projekt gati, por herën e kaluar ka qenë një gabim nga drejtoria jonë, prandaj e sjellim sot.

Z.Atird Hoxha – S’kam gjë në lidhje me këtë investim, ndërkohë që ka kaq shumë për të bërë. Ne kemi miratuar një buxhet. Nëqoftëse, do na vijnë gjithmonë projekte të tilla, për të hequr fonde...., pasi këto fonde sot do ti hiqen gjelbërimit. Ju.keni votuar Projekt/ buxhetin,pra hiqet diku dhe, vihet diku. Pra, nuk është e ndershme..Edhe për varrezat që thoni....kërkoni të bëni pllaka betoni..

Z.Klaudio Mehmetaj – Ka qenë e parashikuar tek prioritetet kjo rrugë. Ne nga FSHZH kemi marrë gjelbërim, trotuarë, stola...dhe është vlerë në lekë që zbriten.

Z.Gjergji Nika – Në komisionin e shërbimeve u diskutua ky projektvendim. Jam dakort me mënyrën si e shtroi drejtori, që e kishte gabim, nga drejtoria..

Znj.Elpinijë Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro – 39 vota

Kundër – 1 votë, znj.Rajmonda Zoto

Znj.Rajmonda Zoto – Jam kundër të hiqet nga gjelbërimi...Tek rruga e “Lamanaj”-ve , ka kohë pa investim. Ky investim më parë të kalojë atje, pastaj jap dakortësinë.

Z.Ervis Moçka – Jam dakort me zonjën Rajmonda. Por jam dakort dhe me sqarimin që bëri drejtori, që në lidhje me zënien e hapsirave publike, pra rehabilitimit...nuk hiqet vetëm gjelbërim., por stola,, dhe këto lekë mbeten të lira, prandaj do investohet këtu.

Znj.Elpinijë Mërkuri – Kalojmë dhe njëherë në votim.

Pro – 38 vota

Kundër – 2 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 5/13, datë 30.04.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika “Të ndryshme “.

Kush e do fjalën ?

Z.Gëzim Çapoj – Në lidhje me projektvendimet që vijnë nga administrata, të mbrohen nga drejtori, nga administrata dhe jo që diskutohet në komision dhe, kryetari i komisionit , e mbron. -E dyta, jemi në sezonin turistik. Do të doja nga drejtorja e turizmit një informacion...Kemi një infrastrukturë të shkatërruar...Dua një informacion shumë të detajuar , qoftë për infrastukturën , ndriçimin, pastrimin (Njësia administrative Orikum)

Në mbledhjen tjetër të jetë 1 pikë, të kemi një informacion në lidhje me sezonin turistik.

Z.Atird Hoxha – Nga Tuneli deri tek Ura e Izvorit, rruga është totalisht e shkatërruar. Të kthehet në gjendje funksionale.

Z.Myzafer Elezi – Do diskutoja në lidhje me një aks rrugor, rreth 300m, me shumë gropa, në Rajonin Nr 5, në lagjen “Kushtrimi”. E pakalueshme.(Depozituar kërkesa)

Znj.Edlira Kapllanaj – Tek Rajoni Nr 2, rruga është rehabilituar deri tek Shtëpia e Fëmijës, nuk ka shkuar më lart. Nuk është shtruar rruga mbi Shtëpinë Foshnjës .

2-Pse po vonohen punësimet tek sektori i pastrimit?

-Ditën e enjte të çdo muaji, të zhvillohen mbledhjet e këshillit të bashkisë. Nuk kam mundësi ditët e tjera.

Znj.Evis Allushi – Pika “Të ndryshme”, është shumë e rëndësishme.

Shqetësimi i parë , furgonat që ofrojnë shërbime gjatë furnizimit, krijojnë shumë problem për trafikun. Të vendoset një orar .

-Për mjetet e tonazhit të rëndë, duhet dhe për këto një orar i caktuar për qarkullim.

-Të ktheja në vëmendje vendim të këshillit bashkiak të vitit 1937, kur kryetar bashkie ka qenë Ali Asllani (lexon vkb ...) Ndër të tjera , thekson për periudhën 1Maj deri në 15 Shtator, orar për mbylljen e dyqaneve, hoteleve etj... Këtë shqetësim e kanë qytetarët, bizneset...

Pra, nëqoftëse, do të ishte e mundur të lihej një orar për mbylljen e dyqaneve , një pushim në orarin e drekës.

Z.Gjergji Nika – Detyrë për sekretarin e këshillit. Mediat s’kanë pse të largohen në pikën”Të ndryshme “. Kryetar s’ka. Nënkryetarë s’ka .

Drejtorë s’ka. Për çfarë flasim ? Le ti japim seriozitet. Ne shkojmë në komisione që i shtjellojmë gjërat dhe më pak diskutime në mbledhje. Merreni me seriozitet këtë gjë.

Z.Edison Kapaj – Shumë shqetësim , mungesa e ujit të pijshëm në Këkrovë, Panaja, Oshëtimë. Abuzohet me rrjetin. Kërkoj ngritjen e grupit të taskë forcës.

Gjithashtu problem uji i pijshëm dhe në fshatin Zvërnec dhe Babicë e Madhe . Këto dy fshatra kanë mungesë të ujit dhe në verë. Të merren masa, s’kanë gjetur zgjidhje.

Z.Atird Hoxha – Duke u bashkuar me shqetësimin e zotit Nika , të gjithë kemi punë , por të gjithë duhet të qëndrojmë deri në fund. Është e pafalshme, e patolerueshme...Ose pika “Të ndryshme “, të jetë pikë e parë e rendit të ditës, ose zgjedhim, mbledhjen e vazhdojmë mbasdite.

Znj.Alta Haluci – Me Aleancën e Grave, ishim në qytetin e Sarandës, problemet e arsimit, kalonin atje....Komisioni i arsimit, është mbledhur vetëm 1 herë, ose të presim ndonjë projektvendim..

Mësues mbështetës sa ka ? Komisioni për barazinë gjinore, nuk është mbledhur. Shikoje këtë çështje zonja kryetare. Kaq në rregull i kemi gjërat, as komision arsimit,as i barazisë gjinore , as i shëndetësisë ? Nuk është vetëm komisioni juridik dhe i financës. Komisionet e rëndësishme , duhet të diskutojnë të gjitha.

Z.Daut Zëraj – Komisionet mblidhen me programin e mbledhjes së radhës. Por nuk ju pengon asnjë, të mblidheni për çështje të caktuara.

Z.Ervis Moçka – Nisemi nga fakti...Është e kotë të diskutojmë pikën “Të ndryshme “ me njëri tjetrin.

E nderuar Kryetare dhe i nderuar Sekretar !

Përsa i përket rregullores,... theksoi zoti Çapoj që çdo projektvendim duhet ta mbrojë drejtori..Po, ta mbrojë. Edhe për pikën të ndryshme, ta vendosim të parën, dhe orarin ta shikojmë ...Por që ne e diskutojmë gjithmonë , të rrespektohet rregullorja.Ti jepet rëndësi .

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – E keni kërkuar që të referojnë kryetarët e komisioneve. Më parë relatonin drejtorët, kështu e kërkuat. Për orarin e zhvillimit të mbledhjes, diskutojmë në konferencën e kryetarëve.

Faleminderit !